

P. P.ushma



PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
Nr. 68/6 Prot.  
Datë 26.02.2021  
DREJTORIA Koad. Tusha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT  
DURRËS**

Z. Kholi

Nr. 218 Prot

Durrës, më 25.02.2021

**Lënda :** Dërgohet raporti vjetor i veprimtarisë së Prokurorisë së Apelit Durrës

**Drejtuar :**

**PROKURORISË SË PËRGJITHSHME  
TIRANË** ✓

Bashkëlidhur ju dërgojmë Raportin Vjetor të Prokurorisë së Apelit Durrës, për vitin 2020, të hartuar në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimit të Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhërin Nr 164, datë 18.12.2020 “Për miratimin e rregulloreve standart të organizimit dhe funksionimit të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apeleve” dhe Rregulloren e Prokurorisë së Apelit Durrës,

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

**DREJTUESI I PROKURORISË APELIT**

**Ludovik DODAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT DURRËS

ANALIZA VJETORE

e

**Prokurorisë Apelit Durrës për vitin 2020**

Në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 50 të ligjit 97/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin të Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhërit Nr 164, datë 18.12.2020, “Për miratimin e rregulloreve standart të organizimit dhe funksionimit të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apeleve” dhe Rregullores së brendshme të Prokurorisë së Apelit Durrës, parashtror në mënyrë të përmbledhur përpara Prokurorit të Përgjithshëm treguesit e përgjithshëm të punës dhe veprimtarisë së Prokurorisë Apelit Durrës dhe të prokurorëve pranë kësaj prokurorie gjatë vitit 2020.

Në total numri i çështjeve është 1009. Nga këto:

- 941 çështje penale janë përfunduar në vitin 2020 (90 prej tyre të mbartura nga viti 2019).
- 68 çështje janë mbartur për gjykim për vitin 2021.

941 çështjet e gjykuara në vitin 2020, sipas objektit të gjyqimit janë:

- 217 çështje janë me objekt themeli që i përkasin (fajësisë, cilësimit ligjor, llojit, masës dhe alternativave të dënimit)
- 237 çështje janë me objekt administrativo penale (kundërshtim vendimeve të prokurorit, etj)
- 487 çështje me objekt vleftësim, caktim e zëvendësim mase sigurimi

**CËSHTJET E PËRFUNDUARA GJATË VITIT 2020**

Viti 2020	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë	Krimet e Rënda dhe SPAK
<b>Gjyk themeli e administrativo-penale</b>	<b>454</b>	245	146	58	5
Gjykimi i çështjeve me objekt: <b>Masa sigurimi</b>	<b>487</b>	269	170	47	1
<b>TOTAL</b>	<b>941</b>	<b>514</b>	<b>316</b>	<b>105</b>	<b>6</b>

Referuar llojit të veprave penale rezulton se veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike<sup>1</sup> me 110 çështje zenë numrin me të madh të çështjeve që janë bërë objekt gjykimi në Gjykatën e Apelit Durrës, që pasohet nga veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike<sup>2</sup> me 90 çështje dhe veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore<sup>3</sup> me 48 çështje të gjykuara.

**Treguesit analitikë sipas llojit të veprave penale dhe rretheve gjyqësore, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:**

Viti 2020	Durrës	Elbasan	Kavajë	Krimet e Rënda	Gjithsej
krimet kundër jetës dhe shëndetit, nenet 76-84/a k.p.	11	14	3	2	30
veprat penale me dashje kundër shëndetit, nenet 86-90	10	11	0	0	21
krimet seksuale, nenet 100-108/a k.p.	5	1	0	0	6
krimet kundër lirisë, moralit dhe familjes, nenet 109-130/a, k.p.	17	23	6	1	47
krimet kundër pasurisë dhe sferën ekonomike, nenet 134 -162 k.p.	51	25	14	0	90
krimet në fushën e doganave dhe tatimeve, nenet 171-182 k.p.	8	1	0	0	9
krimet e fallsifikimit monedhave e dokumentave, nenet 183-192 k.p.	17	5	3	0	25
v. penale kundër tokës, mjedisit e ndërtimeve, nenet 199-207/ç te k.p.	4	1	3	0	8
v. penale kundër veprimtarisë shtetërore, nenet 235-260 k.p.	28	14	6	0	48
veprat penale rendit dhe sigurisë publike, nenet 261-293/d, k.p.	54	41	14	1	110
veprat penale kundër drejtësisë, nenet 300-324 k.p.	7	12	0	0	21

Në vështrim krahasues ndërmjet çështjeve të gjykuara në vitin 2020 dhe atyre të gjykuara në vitin 2019, raporti ndërmjet këtyre dy periudhave paraqitet si vijon:

Në vitin 2020 ka përfunduar gjykimi për 941 çështje penale, në një kohë që në vitin 2019 janë përfunduar 1093 çështje penale. Sipas objektit të gjykimit rezulton se është përfunduar gjykimi në apel për: 217

<sup>1</sup>Vepra penale këto të parashikuara nga nenet 261-293 të k.penal

<sup>2</sup> Vepra penale të parashikuara nga nenet 134-162 të k.penal

<sup>3</sup> Vepra penale të parashikuara nga nenet, nenet 235-260 k.penal

çështje me objekt themelin e çështjes; 237 çështje janë me objekt administrativo penale dhe 487 çështje me objekt vleftësim, caktim e zëvendësim mase sigurimi.

Nuk ka përfunduar gjykimi për 66 çështje themeli dhe administrativo penale të cilat kryesisht ishin planifikuar për gjykim në nëntor/dhjetor 2020 dhe 2 çështje me objekt masë sigurimi.

Krahasuar me vitin 2019 rezulton se numri i çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2020 është më i vogël në diferencën prej 152 çështje. Kjo ka ardhur për faktin se vendi në vitin 2020 u përfshi nga pandemia duke sjellë ngadalësim të proceseve gjyqësore. Kjo duket qartë nga ulja e numrit të çështjeve të themelit (gati ½ e çështjeve të vitit të mëparshëm) dhe ka rritje me 136 çështje të masave të sigurimit që janë shqyrtuar brenda përcaktimeve të aktit normativ të Këshillit të Ministrave mbi pandeminë.

#### Çështjet e gjykuara gjatë vitit 2019

2019	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk. themeli	410	213	150	47
Masa sigurimi	351	181	129	41
Lirim me kusht	29	9	15	5
Gjykim të tjera	303	129	130	44
<b>Totali</b>	<b>1093</b>	<b>532</b>	<b>424</b>	<b>137</b>

#### Çështjet e gjykuara gjatë vitit 2020

2020	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë	Krimet e Rënda
Gjyk. themeli	217	110	77	27	3
Masa sigurimi	487	269	170	47	1
Lirim me kusht	12	6	2	4	0
Gjykim të tjera	225	129	67	27	2
<b>Totali</b>	<b>941</b>	<b>514</b>	<b>316</b>	<b>105</b>	<b>6</b>

Për vitin 2020, të ndara sipas rretheve gjyqësore, rezulton se ka përfunduar gjykimi për 941 çështje, të ndara sipas rretheve gjyqësore rezulton se: 514 çështje i përkasin rrethit gjyqësor Durrës, 316 çështje rrethit gjyqësor Elbasan dhe 105 rrethit gjyqësor Kavajë dhe 6 çështje i përkasin Gjykatës së Krimeve të Rënda.

Rezulton se prokurorët e rretheve gjyqësore Durrës, Elbasan, Kavajë dhe të ardhura nga Krimet të Rënda, kanë ushtruar gjithsej 220 ankime ndaj vendimeve të gjykatës së faktit, të ndara sipas rretheve: 138 ankime ndaj vendimeve të gjykatës rrethit Durrës, 67 ankime ndaj vendimeve të gjykatës rrethit gjyqësor Elbasan, 14 ankime ndaj vendimeve të gjykatës rrethit gjyqësor Kavajë dhe 1 ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Krimeve të Rënda.

## CËSHITJET E GJYKUARA GJATË VITIT 2020

Treguesit analitikë të çështjeve të gjykuara gjatë vitit 2020 të ndara sipas rretheve gjyqësore, objektit gjykimit, dhe subjektit ankimes, paraqiten sipas tabelave të mëposhtme:

Treguesit sipas rretheve gjyqësore

2020	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë	Krimet e Renda
<b>Gjyk themeli e objekte te tjera</b>	<b>454</b>	245	146	58	5
Gjykimi i ceshtjeve me objekt: <u>Masa sigurimi</u>	<b>487</b>	269	170	47	1
<b>TOTAL</b>	<b>941</b>	<b>514</b>	<b>316</b>	<b>105</b>	<b>6</b>

Të dhënat e ankimeve të ushtruara në total për vitin 2020, sipas ankuesit paraqiten të detajuara në tabelën e mëposhtme:

ANKIMET 2020	I pandehuri/i dëmtuari akuzues	Prokurori	Prok./Pand.etj.	TOTAL
Gjyk Themeli e objekte te tjera	331	104	19	<b>454</b>
Gjyk. Masa sigurimi	390	77	20	<b>487</b>
Total	<b>721</b>	<b>181</b>	<b>39</b>	<b>941</b>

E zberthyer sipas objektit te gjykimit sipas ankuesit dhe rretheve, paraqitet si më poshtë vijon:

Ankime 2020 <u>Themel dhe administrativo-penale</u>	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë	Krimet e Renda
<b>Totali</b>	<b>454</b>	<b>245</b>	<b>146</b>	<b>58</b>	<b>5</b>
Ankim pandehuri/persona nën hetim/ i dëmtuari	331	166	114	47	4
Ankim Prokurori	104	66	29	9	0
Ankim Prok./Pand.etj.	19	13	3	2	1

<b>Ankime 2020</b> <b>Masa sigurimi</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>Durrës</b>	<b>Elbasan</b>	<b>Kavajë</b>	<b>Krimet e Rënda</b>
<b>Totali</b>	<b>487</b>	<b>269</b>	<b>170</b>	<b>47</b>	<b>1</b>
Ankim i Pandehuri/persona nën hetim/ i demtuari	390	210	135	44	1
Ankim Prokurori	77	47	27	3	0
Ankim Prok./Pand.etj.	20	12	8	0	0

Numri i çështjeve të ardhura mbi ankimin e prokurorit dhe prokuror/I pandehur gjatë vitit 2020, paraqitet si më poshtë:

<b>Ankime 2020</b>	<b>Themel</b>	<b>Masa sigurimi</b>	<b>Total</b>
Ankim Prokurori	104	77	<b>181</b>
Ankim Prok./Pand.etj.	19	20	<b>39</b>
<b>TOTAL</b>	<b>123</b>	<b>97</b>	<b>220</b>

Çështje me objekt themel dhe administrativo-penale: Ka përfunduar gjykimi i çështjeve objekt fajësisë, cilësimit ligjor, llojit, masës dhe alternativat e dënimit, gjithsej 454 çështje, të cilat:

Sipas rretheve gjyqësore i përkasin:

- 245 rrethit gjyqësor Durrës
- 146 rrethit gjyqësor Elbasan
- 58 rrethit gjyqësor Kavajë
- 5 Gjykatës së Krimeve të Rënda.

Për këto çështje rezulton se:

- në 331 raste ato kanë ardhur për tu gjykuar në shkallë të dytë mbi ankimin e të pandehurve/mbrojtësve/demtuari/ankues
- 123 raste mbi ankimin e prokurorëve(nga të cilat për 19 çështje ka ushtruar ankim edhe i pandehuri).

Çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi: Ka përfunduar gjykimi i çështjeve objekt vleftësim, caktim apo zëvendësim mase sigurimi, gjithsej 487 çështje, të cilat:

Sipas rretheve gjyqësore i përkasin:

- 269 rrethit gjyqësor Durrës
- 170 rrethit gjyqësor Elbasan
- 47 rrethit gjyqësor Kavajë
- 1 çështje Krimeve të Rënda.

Për këto çështje rezulton se:

- o në 390 raste ato kanë ardhur për tu gjykuar në shkallë të dytë mbi ankimin e të personave nën hetim/mbrojtësve
- o 97 raste mbi ankimin e prokurorëve(nga të cilat për 20 çështje ka ushtruar ankim edhe i pandehuri).

Nga këta tregues rezulton se kundërshtimi i vendimeve gjyqësore të gjykatave të shkallës parë është bërë në gati 23% çështjeve nga ana e prokurorëve dhe 77% të çështjeve io përkasin ankimeve të të pandehurve dhe të dëmtuarve akuzues.

**Për rrethin gjyqësor Durrës,** rezulton se janë gjykuar gjithsej 514 çështje penale, nga të cilat 245 janë çështje themeli e administrative penale dhe 269 çështje janë me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi. Nga raporti si subjekte ankuese rezulton se:

Nga të pandehurit është ushtruar ankim në 376 raste përkatësisht:

- o 166 ankime për çështjet me objekt themel/ administrative penale
- o 210 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi).

Nga ana e prokurorit është ushtruar ankim në 138 raste(për 25 nga të cilat ka ushtruar ankim edhe i pandehuri). Këto 138 ankime janë ushtruar përkatësisht:

- o 79 çështje me objekt themel/administrative penale
- o 59 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi).

Ankime të ushtruara për rrethin Durrës	Themel/administrativo-penale	Masa Sigurimi	Total
Prokurori	66	47	113
Prokuror / i pandehur	13	12	25
I pandehuri	166	210	376
<b>Total</b>	<b>245</b>	<b>269</b>	<b>514</b>

Nga treguesit e mësipërm rezulton se 50 % e çështjeve i përkasin kësaj prokurorie, numri i çështjeve për këtë rreth gjyqësor është më perafërt krahasuar me 532 çështje të gjykuara në vitin 2019.

**Për rrethin gjyqësor Elbasan** rezulton se janë gjykuar gjithsej 316 çështje penale, nga të cilat 146 janë çështje themeli /administrative penale dhe 170 çështje me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi.

Nga raporti si subjekte ankuese rezulton se:

Nga të pandehurit është ushtruar ankim në 249 raste përkatësisht:

- o 114 ankime për çështjet me objekt themel/ administrative penale
- o 135 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi).

Nga ana e prokurorit është ushtruar ankim në 67 raste(për 11 nga të cilat ka ushtruar ankim edhe i pandehuri). Këto 67 ankime të prokurorit janë ushtruar përkatësisht:

- o 32 ankime për çështjet me objekt themel/administrative penale
- o 35 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi).

Ankime të ushtruara për rrethin Elbasan	Themel/administrativo-penale	Masa Sigurimi	Total
Prokurori	29	27	56
Prokuror / i pandehur	3	8	11
I pandehuri	114	135	249
<b>Total</b>	<b>146</b>	<b>170</b>	<b>316</b>

Për çështjet e themelit, administrative penale dhe ato me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi konstatohet se numri i çështjeve të gjykuara në shkallë të dytë për këtë rreth gjyqësor është disi më i ulët

krahasuar me 424 çështje të gjykuara për këtë rreth gjyqësor në vitin 2019. Vihet re një ulje e cila ka ardhur për shkak të situatës së pandemisë COVID siç u sqarua edhe më lart.

**Për rrethin gjyqësor Kavajë** rezulton se janë gjykuar gjithsej 105 çështje penale, nga të cilat 58 janë çështje themeli /administrative penale dhe 47 çështje janë me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi.

Nga Raporti si subjekte ankuese rezulton se:

Nga të pandehurit është ushtruar ankim në 91 raste përkatësisht:

- 47 ankime për çështjet me objekt themel/ administrative penale
- 44 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi).

Nga ana e prokurorit është ushtruar ankim në 14 raste(për 2 nga të cilat ka ushtruar ankim edhe i pandehuri). Këto 14 ankime të prokurorit janë ushtruar përkatësisht:

- 11 ankime për çështjet me objekt themel/administrative penale
- 3 ankime për çështjet me objekt masa sigurimi).

Ankime të ushtruara për rrethin Kavajë	Themel/administrativo-penale	Masa Sigurimi	Total
Prokurori	9	3	<b>12</b>
Prokuror / i pandehur	2	0	<b>2</b>
I pandehuri	47	44	<b>91</b>
<b>Total</b>	<b>58</b>	<b>47</b>	<b>105</b>

Për çështjet e themeli, administrative penale dhe ato me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi konstatohet se numri i çështjeve të gjykuara në shkallë të dytë për këtë rreth gjyqësor është disi më i ulët krahasuar me 137 çështje të gjykuara për këtë rreth gjyqësor në vitin 2019.

**Për Gjykatën e Krimeve të Rënda** rezulton se janë gjykuar gjithsej 6 çështje penale, nga të cilat 5 çështje themeli /administrative penale dhe 1 çështje me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi.

Nga raporti si subjekte ankuese rezulton se:

Nga të pandehurit është ushtruar ankim në 5 raste përkatësisht:

- 4 ankime për çështjet me objekt themel/ administrative penale
- 1 ankim për çështjet me objekt masa sigurimi).

Nga ana e prokurorit është ushtruar ankim në 1 rast me objekt themel (për të cilin ka ushtruar ankim edhe i pandehuri).

Ankime të ushtruara për Krimet e Rënda	Themel/administrativo-penale	Masa Sigurimi	Total
Prokurori	0	0	<b>0</b>
Prokuror / i pandehur	1	0	<b>1</b>
I pandehuri	4	1	<b>5</b>
<b>Total</b>	<b>5</b>	<b>1</b>	<b>6</b>



Çështjet e gjykuara mbi ankimin e prokurorit; Gjatë vitit 2020, mbi ankimin e prokurorëve të prokurorive të shkallës parë, janë gjykuar gjithsej 220 çështje nga 223 çështje që janë gjykuar në vitin 2019.

Të ndara sipas rretheve gjyqësore, rezulton se:

- 138, ankime i përkasin Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës
- 67 ankime i përkasin Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan,
- 14 ankime i përkasin Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Kavajë
- 1 ankim i ardhur nga Krimet e Rënda.

Çështjet penale të gjykuara në shkallë të dytë mbi ankimin e prokurorit, të ndara sipas rretheve gjyqësore dhe objektit gjykim, treguesit paraqiten si më poshtë:

Ankim Prokurori	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Krimet e Rënda	Gjithsej
Gjyk themeli Adm.pen.	79	32	11	1	123
Masa sigurimi	53	35	3	0	97
<b>Totali</b>	<b>138</b>	<b>67</b>	<b>14</b>	<b>1</b>	<b>220</b>

Çështjet penale të gjykuara në shkallë të dytë mbi ankimin e te pandehurit, të ndara sipas rretheve gjyqësore dhe objektit gjykim, treguesit paraqiten si më poshtë;

Ankim pandehuri	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Krimet e Rënda	Gjithsej
Gjyk themeli Adm.pen.	166	116	47	4	331
Masa sigurimi	210	135	44	1	390
<b>Totali</b>	<b>376</b>	<b>249</b>	<b>91</b>	<b>5</b>	<b>721</b>

Çështjet penale të gjykuara në shkallë të dytë mbi ankimin e prokurorit dhe të pandehurit, të ndara sipas rretheve gjyqësore dhe objektit gjykim, treguesit paraqiten si më poshtë;

Ankim Prokurori/Pandehuri	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Krimet e Rënda	Gjithsej
Gjyk. themeli, Administrative penale	245	146	58	5	454
Masa sigurimi	269	170	47	1	487
<b>Totali</b>	<b>514</b>	<b>316</b>	<b>105</b>	<b>6</b>	<b>941</b>

Çështjet penale të gjykuara në shkallë të dytë mbi ankimin e Prokurorit dhe prokuror + i Pandehuri, të ndara sipas përfaqësimit nga prokurorët e apelit dhe objektit gjykim, treguesit paraqiten si më poshtë

Ankim Prokurori/Pandehuri	L. Dodaj	M. Duda	A. Ndoi	Total
Gjyk. themeli, Administrative penale	23	47	53	123
Masa sigurimi	15	42	40	97
<b>Totali</b>	<b>38</b>	<b>89</b>	<b>93</b>	<b>220</b>

Objekt i ankimeve të ushtruara nga prokurorët e shkallës parë në rreth 55% të çështjeve kanë patur kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të rrethit gjyqësor në lidhje me themelin e çështjeve, për deklarimin fajtor, cilësimin ligjor të veprës penale, llojin dhe masën e dënimit dhënë të pandehurve dhe çështjet admkinistrativo-penale. Një numër i konsiderueshëm i ankimeve i përket aplikimit të dënimeve alternative të dhënë nga gjykatat e faktit për të cilat prokurorët nuk kanë qenë dakord dhe kanë ushtruar ankim në shkallë të dytë.

#### **Qëndrimi i prokurorëve të apelit ndaj ankimeve të prokurorëve të rretheve gjyqësore**

Nga 220 çështjet e ankimuara nga prokurorët e rretheve, prokurorët e apelit kanë mbajtur qëndrimet si vijon:

- o 163 ankime të prokurorëve janë përkrahur.
- o 8 ankime janë gjykuar në dhomë këshillimi dhe në mungesë për shkak të arsyeve objektive
- o 49 ankime të prokurorëve të rretheve nuk janë përkrahur nga prokurorët e apelit nga të cilat:
  - në 15 raste është hequr dorë nga ankimi, duke i dërguar aktet e heqjes dorë prokurorëve.
  - Për 29 ankime është kërkuar lënia në fuqi të vendimeve të rrethit duke I lënë akses Gjykatës së Apelit për zgjidhjen e çështjes. Në këto raste edhe gjykata e apelit nuk ka patur qëndrim të ndryshëm nga kërkesat e prokurorit të apelit.
  - Për 3 ankime është kërkuar mospranimi I tyre. (këto ankime I përkasin çështjeve me object kundërshtim vendim mosfillimi dhe pushimi).
  - Për 2 ankime, prokurori ka kërkuar kthimin e çështjes për rigjykim.

Rastet e heqjes dorë nga ankimi i prokurorëve të shkallës parë, të ndara rretheve gjyqësore dhe për secilin prokuror, treguesit paraqiten si më poshtë;

Hequr dorë nga ankim Prokurorit	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
L. Dodaj	3	2	0	5
M. Duda	4	1	0	5
A. Ndoi	3	1	1	5
<b>Gjithsej</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>15</b>

Heqjet dorë nga ankimi i prokurorëve. Sikurse rezulton nga treguesit analitikë, nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie për këto çështje rezulton se është deklaruar heqja dorë vetëm në 15 raste nga 220 ankime të ushtruara. Rastet e heqjeve dorë i përkasin 10 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 4 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 1 rast Prokurorisë Rrethit Kavajë.

Rastet e heqjes dorë nga ankimi i prokurorit përkasin ankimeve për kundërshtimin e aplikimit të dënimeve alternative sipas neneve 59, 63 të k.penal apo për masë dënimi. Në përgjithësi të gjitha rastet heqjeve dorë nga ana e prokurorëve ato janë diskutuar paraprakisht me prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe drejtuesin e prokurorive, vlerësohet se për çdo rast të heqjeve dorë nga ankimi, prokurorët janë bazuar në bindjen e tyre të brendshme si dhe bazuar në kërkesat e ligjit penal material e procedural penal.

Edhe në vitin 2020, ashtu si në vitet e mëparshme është konstatuar e njëjta problematikë në formulimin dhe argumentimin e ankimeve të ushtruara nga ana e prokurorëve të prokurorive të rretheve gjyqësore. Kryesisht është konstatuar që në ankimet e prokurorëve nuk i kushtohet kujdës argumentimit ligjor se pse kundërshtohet vendimi i gjykatës, më tepër në ankime shihen rrethanat e faktit se sa argumentimi ligjor. Gjithashtu vërehet se në kërkesat përfundimtare prokurorët nuk citojnë mënyrën e zgjidhjes së çështjes por mjaftohen me shprehjen “Sipas konkluzioneve të prokurorit në seancë gjyqësore” duke vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e nenit 428 të K.pr. Penal për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Kjo problematikë është bërë prezente verbalisht prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorive, pasqyruar në konkluzionet përkatëse të prokurorëve të apelit.

### **Qëndrimi i gjykatës së apelit ndaj ankimeve të prokurorëve të rretheve gjyqësore**

Nga 220 rastet e ankimeve të ushtruara nga prokurorët e rretheve, rezultojnë se 163 ankime janë përkrahur nga prokurorët e apelit dhe është kërkuar në gjykatën e apelit ndryshimet e vendimeve sipas thelbit të ankimit dhe Gjykata e Apelit Durrës, ka pranuar 26 prej tyre ose e thënë ndryshe 16% e tyre. Ky tregues është më i ulët se një vit më parë dhe në vlerësimin tonë ka ardhur edhe për shkak të situatës së pandemisë COVID 19, ku gjykatat janë prirur më shumë për lehtësimin e pozitave si tek masat e sigurimit, dënimet alternative dhe lirimet me kusht.

Rastet e ankimeve të prokurorëve të rretheve, të pranuar dhe të përkrahura nga gjykata e apelit Durrës, të ndara sipas rretheve gjyqësore dhe për secilin prokuror, treguesit paraqiten si më poshtë;

<b>Ankim Prokurori i pranuar</b>	<b>Prok Durrës</b>	<b>Prok Elbasan</b>	<b>Prok Kavajë</b>	<b>Gjithsej</b>
L. Dodaj	0	3	0	3
M. Duda	5	2	0	7
A.Ndoi	11	3	2	16
<b>Gjithsej</b>	<b>16</b>	<b>8</b>	<b>2</b>	<b>26</b>

Siç duket edhe nga tabela e mësipërme, rezultojnë se rastet e pranimit të ankimeve të ushtruara nga prokurorët, i përkasin 16 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, 8 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 2 ankime Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Kavajë.

**Cështjet me objekt administrativo penal të gjykuara gjatë vitit 2020 paraqiten të grupuara sipas objektit si më poshtë vijon:**

Për çështjet penale me objekt lirim me kusht sipas nenit 64 të k.penal. Gjatë vitit 2020 janë bërë objekt gjykimi 12 çështje gjithsej nga të cilat:

- o 5 raste janë të rrethit gjyqësor Durrës
- o 3 raste janë të rrethit gjyqësor Elbasan
- o 4 raste janë të rrethit gjyqësor Kavajë.

Këto çështje kanë ardhur: 4 çështje mbi ankimin e prokurorëve dhe 8 çështje mbi ankimin e të dënuarit. Nga 4 ankimet e prokurorit gjykata e apelit ka pranuar 2 prej tyre duke vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe rrëzimin e kërkesës për lirim me kusht.

Si edhe në vitet e mëparshme, numri i çështjeve me këtë objekt gjykimi, ndonëse rezultojnë i ulët për shkak të veprimtimit të ligjeve për dhënie amnistie, në përgjithësi evidenton formalizëm në ankimin e prokurorëve

të shkallës parë, nuk bëhet analizë e kërkesave të ligjit si dhe rrethanave dhe sidomos veçorive të dënuarit objekt gjykimi në raport edhe me praktikën gjyqësore të unifikuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës Lartë me vendimin Nr 2 datë 25.05.2015.

Çështjet me objekt kundërshtimin e vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal. Këto çështje bëhen objekt gjykimi në gjykatën e apelit kryesisht mbi ankimin e palëve ndaj vendimeve administrative penale të prokurorisë dhe gjykatave të rretheve gjyqësore. Gjatë vitit 2020 ka përfunduar gjykimi për 59 çështje me këtë objekt gjykimi nga të cilat 15 çështje kanë ardhur mbi ankimin e prokurorëve dhe 44 kanë ardhur mbi ankimin e personave të interesuar.

15 çështjet me ankim prokurori kanë marrë këto zgjidhje:

- 2 ankime janë përkrahur si nga prokurori i apelit edhe nga gjykata e apelit.
- 5 ankime janë përkrahur nga prokurori i apelit por janë rrëzuar nga gjykata e apelit duke lënë fuqi vendimet e gjykatave të rrethit për regjistrimin e procedimeve penale.
- 4 ankime nuk janë përkrahur si nga prokurori i apelit ashtu edhe nga gjykata e apelit të cilët kanë ndarë të njëjtin qëndrim për regjistrimin e procedimit penal.
- 4 ankime janë shqyrtuar në mungesë të prokurorit dhe gjykata ka vendosur mospranimin e ankimit të prokurorit të rrethit duke lënë në fuqi vendimet e shkallës parë për regjistrim procedimi penal.

Për këto çështje duhet të evidentojmë faktin se nga prokurorët e prokurorive të rretheve gjyqësore në mjaft raste mbahen qëndrime të gabuara, ndonëse kryen veprime hetimore dhe çështja duhet të regjistrohet edhe për shkak të elementëve të kallëzimeve, nga ana e prokurorëve vendoset mosfillimi i procedimit penal, në mjaft raste jo të bazuara në prova dhe ligj.

Çështjet me objekt kundërshtimin e vendimeve të prokurorit për pushimin e procedimit penal. Këto çështje bëhen objekt gjykimi në gjykatën e apelit kryesisht mbi ankimin e palëve ndaj vendimeve të prokurorisë dhe gjykatave të rretheve gjyqësore. Gjatë vitit 2020 ka përfunduar gjykimi për 57 çështje me këtë objekt gjykimi nga të cilat 35 kanë ardhur mbi ankimin e prokurorit dhe 22 mbi ankimin e të pandehurit.

35 çështjet me ankim prokurori kanë marrë këto zgjidhje:

- 10 ankime janë përkrahur si nga prokurori i apelit ashtu edhe nga gjykata e apelit duke vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatrës së rrethit dhe pushimin e procedimit penal
- 16 ankime janë përkrahur nga prokurori i apelit por nuk janë pranuar nga gjykata e apelit e cila ka lënë në fuqi vendimet e gjykatave të shkallës së parë për vazhdimin e hetimeve.
- 8 ankime nuk janë përkrahur nga prokurori i apelit duke kërkuar lënien në fuqi të vendimeve të shkallës parë për vazhdim hetimesh dhe gjykata e apelit ka disponuar në të njëjtin mënyrë duke i lënë në fuqi vendimet e shkallës së parë.
- 1 ankim është gjykuar në dhomë këshillimi dhe gjykata e apelit nuk e ka pranuar ankimin e prokurorit.

Çështjet me objekt kërkesë e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq, gjatë vitit 2020 ka përfunduar gjykimi për 22 çështje me këtë objekt gjykimi, nga të cilat 19 kanë ardhur mbi ankim prokurori, dhe 3 mbi ankimin e të pandehurit.

19 ankimet e prokurorit janë pasi gjykatat e shkallës parë kanë vendosur në disa raste pushim çështje në disa të tjera kthimin e akteve prokurorit dhe këto ankime në gjykatën e apelit kanë marrë këto zgjidhje:

- 2 ankime janë pranuar si nga prokurori i apelit ashtu edhe gjykata.
- 14 ankime janë pranuar nga prokurori i apelit, por janë rrëzuar nga gjykata e cila ka lënë në fuqi vendimet e shkallës parë.
- 2 ankime nuk janë pranuar as nga prokurori i apelit dhe as nga gjykata e apelit.
- 1 ankim është gjykuar në dhomë këshillimi dhe gjykata e apelit ka vendosur mospranim ankimi.

Çështjet me objekt njohje vendimi penal të huaj të gjykara gjatë vitit 2020 janë 9 raste nga të cilat 1 ka ardhur mbi ankimin e prokurori dhe 8 raste mbi ankimin e të pandehurit.

Rasti i ankuar nga prokurori, është pranuar nga prokurori i apelit por gjykata nuk e ka pranuar duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit.

Duhet theksuar se nga ana e gjykatës së apelit është mbajtur qëndrim në disa raste duke shqyrtuar çështjet e njohjes së vendimeve penale të huaja edhe në aspektin e vlerësimit të rrethanave për individualizimin e dënimit dhe dënimet alternative. Këto raste nga ana jonë është ushtruar rekurs nga ana jonë në Gjykatën e lartë.

Çështjet me objekt lejim ekstradimi të gjykara gjatë vitit 2020 janë 5 raste të cilat kanë ardhur të gjitha mbi ankimin e të pandehurit. Në këto çështje nga ana e prokurorëve të apelit, janë mbajtur gjithnjë në konsideratë përveç legjislacionit të brendshëm edhe konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare mbi ekstradimin.

### **Rekuret e ushtruara për çështjet e gjykuara në vitin 2020.**

Në përfundim të gjykimit të çështjeve me ankim prokurori dhe të pandehuri, në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk ka pranuar kërkimet e prokurorëve të apelit në seancë gjyqësore, apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë në 53 raste, të cilat të ndara sipas objektit të gjykimit çështjes dhe rretheve gjyqësore, paraqiten me treguesit si më poshtë:

<b>Rekuret</b>	<b>Durrës</b>	<b>Elbasan</b>	<b>Kavajë</b>	<b>Krimet e Rënda</b>	<b>Total</b>
Themel	17	7	1	2	<b>27</b>
Administrativo-penale	7	3	1	0	<b>11</b>
Masa sigurimi	11	2	1	1	<b>15</b>
<b>Total</b>	<b>35</b>	<b>12</b>	<b>3</b>	<b>3</b>	<b>53</b>

Siç duket nga tabela e mësipërme, treguesit e 53 rekurseve sipas rretheve gjyqësore, rezultojnë si vijon:

- 35 Rekurse janë ushtruar për çështje të rrethit gjyqësor Durrës,
- 12 Rekurse për çështje të rrethit gjyqësor Elbasan,
- 3 Rekurse për çështje të rrethit gjyqësor Kavajë
- 3 rekurse për çështje të ardhura nga Krimet e Rënda.

Ndërsa treguesit e rekurseve sipas objektit të çështjeve rezultojnë:

- 27 rekurse për çështje themeli
- 11 rekurse për çështje administrative penale
- 15 rekurse ndaj vendimeve me objekt vleftësim dhe caktim masa sigurimi.

Rastet e rekurseve të ushtruara nga secili prokuror të ndara sipas objektit të gjykimit çështjes, paraqiten me treguesit si më poshtë:

<b>Rekurset</b>	<b>Çështje themeli</b>	<b>Masa sigurimi</b>	<b>Administrative penale</b>	<b>Gjithsej</b>
L. Dodaj	6	0	1	<b>7</b>
M. Duda	13	9	4	<b>26</b>
A.Ndoi	8	6	6	<b>20</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>27</b>	<b>15</b>	<b>11</b>	<b>53</b>

### Mbi ekzekutimin e vendimeve penale.

Edhe ekzekutimi i vendimeve penale është një tregues i rëndësishëm i punës së prokurorisë pasi në njëfarë mënyre finalizohet gjithë ndjekja penale e ushtruar nga prokurori.

Prokuroët në fazën e ekzekutimit janë udhëhequr nga dispozitat e Kodit të Proçedurës penale, Ligjit nr. 79/2020 “Mbi ekzekutimin e vendimeve penale” si dhe urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm për këtë qëllim.

Treguesit e ekzekutimeve për vitin 2020 paraqiten sipas tabelës së mëposhtme

Urdhëra Ekzekutimi	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Krimet e rënda	Gjithsej
Themel/administrativo-penale	11	3	3	0	17
Masa sigurimi	77	47	16	1	141
Totali	88	50	19	1	158

Referuar të dhënave në tabelë, numri i urdhërave të ekzekutimit 158, është një numër i konsiderueshëm që është përballuar nga prokurorët e apelit.

### NGARKESA DHE TREGUESIT E PUNËS PËR SECILIN PROKUROR

#### Prokurori Ludovik Dodaj.

Nga ky prokuror gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2020, është përfaqësuar akuza në gjykimin e 262 çështjeve penale, nga të cilat 14 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2019.

Nuk ka përfunduar gjykimin për 15 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2021, çështje kryesisht të regjistruara në muajin nëntor/dhjetor 2020.

Çështje të përfunduara në vitin 2020, janë 247, të cilat sipas objektit të gjyimit, rezultojnë: 100 çështje me objekt gjykimin e themelit dhe administrative penale dhe 147 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi.

Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 38 çështje (për 4 nga të cilat ka ushtruar ankim edhe i pandehuri), të ushtruara nga prokurorët në 23 çështje themeli e administrative penale dhe 15 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi.

#### Çështjet të përfunduara nga Prokurori Ludovik DODAJ vitit 2020

Viti 2020	Ankim Prokurori	Ankim Prok.+Pand.	Ankimtë Pandehuri etj.	Totali
Gjyk themeli dhe Administrative penale	20	3	77	100
Masa sigurimi	14	1	132	147
Totali	34	4	209	247

**ANALIZA E QËNDRIMIT TË MBAJTUR NGA PROKURORI DHE GJYKATA E APELIT NË LIDHJE ME ÇËSHTJET E ARDHURA ME ANKIM PROKURORI**

**Qëndrimi i prokurorit të apelit në raport me ankimin e prokurorit në rreth**

Për 38 çështjet e ardhura mbi ankimin e prokurorit, qëndrimi i mbajtur i prokurorit të apelit ndaj ankimit të prokurorit në rreth sipas objekteve të gjykimit çështjes, paraqitet me treguesit si më poshtë:

<b>Objekti gjykimit</b>	<b>Përkrahur</b>	<b>Pa qëndrim (dhomë këshillim/mungesë)</b>	<b>Jo përkrahur</b>	<b>Hequr dorë nga ankimi</b>	<b>Total</b>
Themel	5	0	0	1	<b>15</b>
Masa sigurimi	11	0	0	4	<b>15</b>
Kund.vend mosfillimi	1	2	1	0	<b>3</b>
Pushim çështje	2	1	3	0	<b>4</b>
Dergim çështje në gjyq	3	0	1	0	<b>1</b>
Qëndrim në shtëpi	1	0	0	0	<b>0</b>
Konstatim i shkeljes të së drejtës kushtetuese	1	0	0	0	<b>0</b>
Shuarje ekzekutimi dënimi penal	1	0	0	0	<b>0</b>
<b>Total</b>	<b>25</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	<b>5</b>	<b>38</b>

Siç duket edhe nga tabela e mësipërme, qëndrimi i prokurorit të apelit në raport me 38 ankimet e prokurorëve të rretheve gjyqësore, paraqitet si më poshtë:

- **Ankime të përkrahura nga prokurorit i apelit:** janë 25 të cilat sipas objektit të gjykimit rezultojnë: 14 me objekt themel/administrativo penal dhe 11 janë me objekt masa sigurimi.
- **Pa qëndrim mbi ankimin e prokurorit në rreth:** janë 3 çështje gjithsej (2 me objekt kundërshtim vendim mosfillimi dhe 1 me objekt kundërshtim vendim pushimi), pasi 1 çështje është zhvilluar në dhomë këshillimi dhe 2 të tjerat janë zhvilluar në mungesë të prokurorit të apelit për shkak pjesëmarrje në KED.
- **Ankime të papërkrahura nga prokurori i apelit** janë 10 çështje (brenda të cilave përfshihen edhe 5 raste të heqjes dorë nga ankimi i prokurorit). Të 10 rastet të analizuara sipas objektit të gjykimit rezultojnë si më poshtë:

- për 1 çështje me objekt themel ku prokurori i rrethit ka kërkuar dënim me burg, gjykata e rrethit ka vendosur dënim me gjobë, prokurori i apelit ka hequr dorë nga ankimi. Heqja dorë nga ky prokuror është diskutuar me prokurorin e prokurorisë së shkallës parë dhe ka qenë në përputhje me bindjen e tij bazuar në prova, ligjin penal material e procedural penal.
- për 5 çështje administrativo-penale (3 me objekt pushim çështje, 1 me objekt kundërshtim vendim mosfillimi dhe 1 me objekt dërgim çështje në gjyq) prokurori i apelit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit;
- Për 4 çështje me objekt masë sigurimi, prokurori i apelit ka hequr dorë nga ankimi i prokurorit të rrethit ku, në 3 çështje prokurori i rrethit ka kërkuar masën “arrest në burg” dhe 1 çështje masën e “ndalimit të daljes jashtë shtetit”, ndërsa gjykata e rrethit ka vendosur në 3 raste masën “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore” dhe 1 rast masën “garanci pasurore.

### **Qëndrimi i Gjykatës së Apelit në raport me ankimin e prokurorit të rrethit**

Qëndrimi i Gjykatës së Apelit në raport me ankimin e prokurorit të rrethit dhe sipas objekteve të gjykimit çështjes, paraqitet me treguesit si më poshtë:

Objekti gjykimit	Qëndrimi i Gjykatës e Apelit		Total
	Pranuar	Rrëzuar	
Themel	3	5	8
Masa sigurimi	0	15	15
Kund.vend mosfillimi	0	4	4
Pushim çështje	0	6	6
Dërgim çështje në gjyq	0	3	3
Aplikim dënimi alternativ qëndrim në shtëpi	0	1	1
Shuarje ekzekutimi vendimi penal	0	1	1
<b>Total</b>	<b>3</b>	<b>35</b>	<b>38</b>

Siduket edhe në treguesit tabelës së mësipërme, rezulton se nga 38 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqësuar nga ana e prokurorit Ludovik Dodaj gjatë vitit 2020, qëndrimi i Gjykatës të Apelit në raport me ankimin e prokurorit në rreth, paraqitet si më poshtë:

- **Ankime të pranuar nga Gjykata e Apelit janë: 3 çështje** me objekt themel ku akuza në të dyja shkallët e gjykimit është përkrahur edhe nga gjykata e apelit.
- **Ankime të rrëzuara nga Gjykata e Apelit janë 35 çështje**, të cilat të ndara sipas objektit të gjykimit rezultojnë:
  - 5 çështje me objekt themel nga të cilat:
    - në 4 çështje prokurori i apelit ka përkrahur qëndrimin e prokurorit të rrethit por gjykata nuk ka përkrahur akuzën në të dyja shkallët e gjykimit.
    - në 1 çështje, prokurori i apelit ka hequr dorë nga ankimi i prokurorit në rreth e gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit, duke ndarë të njëjtin vlerësim mbi çështjen.
  - 15 çështje me objekt administrativo-penale(3 çështje dërgim për gjyq; 4 çështje kundërshtim vendim mosfillimi; 6 çështje kundërshtim vendim pushimi; 1 çështje aplikim dënimi alternativ “qëndrim në shtëpi”; 1 çështje shuarje ekzekutimi vendimi penal). Nga këto:



- në 5 raste, Prokurori i Apelit dhe gjykata e apelit kanë mbajtur të njëjtin qëndrim duke mos përkrahur qëndrimin e prokurorit në rreth.
- Në 3 raste janë zhvilluar në dhomë këshillimi dhe mungesë për pjesëmarrje në KED dhe gjykata apelit për të 3 rastet nuk e ka përkrahur ankimin e prokurorit në rreth .
- Në 7 raste me objekte (pushim, mosfillim, dërgim gjyq, qëndrim në shtëpi, shuarje ekzekutimi vendimi penal), prokurori i apelit ka përkrahur ankimin e prokurorit në rreth, ndërsa gjykata e apelit nuk e ka përkrahur akuzën në asnjë nga shkallët e gjykimit.
- 15 çështje me objekt masa sigurimi, nga të cilat:
  - në 11 raste, prokurori i apelit ka përkrahur qëndrimin e prokurorit të rrethit por gjykata nuk ka përkrahur akuzën në të dyja shkallët e gjykimit,
  - në 4 çështje, prokurori i apelit ka hequr dorë nga ankimi i prokurorit të rrethit dhe gjykata për këto 4 raste ka vendosur mospranimin e ankimit.

## **ANALIZA E QËNDRIMIT TË MBAJTUR NGA PROKURORI DHE GJYKATA E APELIT NË LIDHJE ME ÇËSHTJET E ARDHURA ME ANKIM TË PANDEHURI**

Për vitin 2020 janë gjykuar nga ky prokuror 209 çështje penale të ardhura mbi ankimin e të pandehurit. Të ndara sipas objektit të gjykimit ato ndahen në:

- 77 çështje me objekt themel dhe administrativo-penale
- 132 çështje me objekt masa sigurimi.

Qëndrimi i mbajtur nga prokurorit i apelit dhe gjykata e apelit mbi 77 çështjet me objekt themel dhe administrativo-penale të ardhura mbi ankimin e të pandehurit dhe të dëmtuarve akuzues.

- **Ankime të papërkrahura nga prokurorit i apelit dhe gjykata e apelit janë 48 raste** për të cilat gjykata e apelit ka ndarë të njëjtin qëndrim me prokurorin e apelit duke rrëzuar ankimet e të pandehurve dhe duke përkrahur akuzën në të dyja shkallët e gjykimit.
- **Gjykime të zhvilluara në dhomë këshillimi: janë 8 çështje** për të cilat gjykata e apelit ka vendosur:
  - në 5 raste mospranimin e ankimit të të pandehurit
  - në 2 raste ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit për pushim çështje duke mospërkrahur ankimin e të dëmtuarit akuzues.
  - në 1 rast ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe pranimin e kërkesës të të pandehurit për rivendosje në afat.
- **Ankime të papërkrahura nga prokurorit i apelit por të pranuar nga Gjykata e apelit janë 21 raste** ndër të cilat:
  - 4 rastet me shkak ankimi deklarim pafajësie. Në 1 rast Prokurori i apelit dhe gjykata e apelit kanë ndarë të njëjtin qëndrim për mospranimin e ankimit. Në 3 raste prokurori i apelit kërkoi lënien në fuqi të vendimit të fajësisë ndërsa gjykata e apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe deklarimin e pafajësisë. Prokurori i apelit ka ushtruar rekurs në 2 raste.
  - 17 raste janë kryesisht me shkak ankimi aplikim dënimesh alternative, masë dënime më të ulët etj, të cilat nuk janë përkrahur nga prokurori i apelit por janë pranuar nga gjykata e apelit. Në 3 raste (me shkak ankimi ndryshim cilësimi juridik të veprës penale, masë dënimi më të ulët dhe aplikim të nenit 59) është ushtruar rekurs nga prokurori i apelit.

Qëndrimi i mbajtur nga prokurorit i apelit dhe gjykata e apelit mbi 132 çështjet me objekt masa sigurimi të ardhura mbi ankimin e të pandehurit, paraqitet si vijon:

- **Ankime të të pandehurit të papërkrahura nga prokurorit i apelit dhe gjykata e apelit janë 95 ankime për të cilat gjykata e apelit ka ndarë të njëjtin qëndrim me prokurorin e apelit duke rrëzuar ankimet e të pandehurve dhe duke përkrahur akuzën në të dyja shkallët e gjykimit.**
- **Gjykime të zhvilluara në dhomë këshillimi: janë 2 çështje për të cilat gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit të të pandehurit.**
- **Ankime të papërkrahura nga prokurorit i apelit por të pranuar nga Gjykata e apelit, janë 35 çështje.**

#### Rekurse të ushtruara nga prokurori Ludovik Dodaj:

Nga 247 çështje të përfunduar për vitin 2020 (nga të cilat 100 janë me objekt themel dhe administrativo-penale dhe 147 çështje me objekt masa sigurimi), nga ky prokuror është ushtruar rekurs në 7 raste nga të cilat:

- 2 çështje kanë ardhur mbi ankim prokurori dhe janë të dyja me objekt themeli.
- 5 çështje (nga të cilat 4 me objekt themel dhe 1 me objekt njohje vendimi penal të huaj) kanë ardhur mbi ankimin e të pandehurit .

#### Prokurori Moisi DUDA.

Nga ky prokuror gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2020, është përfaqësuar akuza në gjykimin e 373 çështjeve penale, nga të cilat 35 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2019.

Nuk ka përfunduar gjykimin për 23 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2021, çështje kryesisht të regjistruara në muajin nëntor/dhjetor 2020.

Çështje të përfunduara në vitin 2020, janë 350, të cilat sipas objektit të gjykimit, rezultojnë: 179 çështje me objekt gjykimin e themelit dhe administrative penale dhe 171 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi.

Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 89 çështje (për 20 nga të cilat ka ushtruar ankim edhe i pandehuri), repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 47 çështje themeli e administrative penale dhe 42 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi.

#### Çështjet të përfunduara nga Prokurori Moisi DUDA vitit 2020

Viti 2020	Ankim Prokurori	Ankim Prok.+Pand.	Ankim të Pandehuri etj.	Totali
Gjyk themeli dhe Administrative penale	39	8	132	179
Masa sigurimi	30	12	129	171
<b>Totali</b>	<b>69</b>	<b>20</b>	<b>261</b>	<b>350</b>

**ANALIZA E QËNDRIMIT TË MBAJTUR NGA PROKURORI DHE GJYKATA E APELIT NË LIDHJE ME ÇËSHTJET E ARDHURA ME ANKIM PROKURORI**

Qëndrimi i prokurorit të apelit në raport me ankimin e prokurorit në rreth dhe sipas objekteve të gjykimit çështjes, paraqitet me treguesit si më poshtë:

Objekti gjykimit	Përkrahur	Jo përkrahur	Hequr dorë nga ankimi	Total
Themel	15	1	1	17
Konvertim denimi	1			1
Kund.vend mosfillimi	3	1	1	5
Pushim çështje	10	3		13
Zgjatje afati hetimesh		1		1
Dergim gjyq	9			9
Lirim me kusht	2			2
Masa sigurimi	31	7	3	41
<b>Total</b>	<b>71</b>	<b>13</b>	<b>5</b>	<b>89</b>

Qëndrimi i prokurorit të apelit në raport me ankimin e prokurorit të rrethit, paraqitet si më poshtë:

Nga 89 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqesuara nga ana e prokurorit Moisi Duda gjatë vitit 2020, rezulton se qëndrimi i prokurorit të apelit në raport me ankimin e prokurorit të rrethit, paraqitet si më poshtë:

- **Ankime të përkrahura nga prokurori i apelit:** janë 71 ankime të cilat sipas objektit të gjykimit rezultojnë: 40 me objekt themel dhe administrativo penal dhe 31 janë me objekt masa sigurimi.
- **Ankime të papërkrahura nga prokurori i apelit:** janë 18 ankime ( brenda të cilave përfshihen edhe 5 raste të heqjes dorë nga ankimi i prokurorit) të cilat sipas objektit të gjykimit rezultojnë:
  - o për 1 çështje me objekt themel ku prokurori i rrethit ka kërkuar deklarinimin fajtor dhe dënimin me burg + aplikim të nenit 59, gjykata e rrethit ka vendosur pafajësi, prokurori i apelit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të pafajësisë, vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga gjykata e apelit.
  - o për 5 çështje administrativo-penale (3 me objekt pushim çështje, 1 me objekt kundërshtim vendim mosfillimi dhe 1 me objekt kërkesë prokurorise për zgjatje afati) prokurori i apelit ka kërkuar në 4 raste lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit për vazhdimin e hetimeve dhe në 1 rast lënien në fuqi të vendimit të gjykatës rrethit për anulimin e vendimit të zgjatjes së afatit të hetimeve;
  - o për 2 çështje prokurori ka hequr dorë nga ankimi.
    - Në 1 çështje me objekt themel, ku prokurori në rreth ka kërkuar deklarinimin fajtor e dënimin me burg, gjykata e rrethit ka vendosur dënimin me gjobë. Prokurori në apel ka hequr dorë dhe gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit.

- Në 1 çështje tjetër me objekt kundërshtim vendim mosfillimi, ku gjykata e rrethit ka vendosur vazhdimin e hetimeve, prokurori i apelit ka hequr dorë dhe gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit.
- Për 10 çështje me objekt masë sigurimi:
  - në 3 raste(ku kërkesa e prokurorit në rreth ka qene për caktim të masës arrest në burg, gjykata e rrethit ka caktuar masën detyrim paraqitje) prokurori i apelit ka hequr dorë nga ankimi i prokurorit të rrethit dhe gjykata ka vendosur mospranim ankimi.
  - Në 7 raste(ku kërkesa e prokurorit në rreth ka qenë caktimi i masës arrest në burg, gjykata e rrethit ka caktuar masën në 2 raste arrest në shtëpi dhe në 5 raste detyrim paraqitje), prokurori në apel ka kërkuar miratimin e vendimit të gjykatës së rrethit.

Qëndrimi i Gjykatës së Apelit në raport me ankimin e prokurorit të rrethit dhe sipas objekteve të gjykimit çështjes, paraqitet me treguesit si më poshtë:

Objekti gjykimit	Qëndrimi i Gjykatës së Apelit		Total
	Pranuar	Rrëzuar	
Themel	5	15	20
Masa sigurimi	2	40	42
Kund.vend mosfillimi		6	6
Pushim çështje		8	8
Dërgim çështje në gjyq		9	9
Zgjatje afati hetimesh		1	1
Rivendosje ne afat		1	1
Lirim me kusht		2	2
<b>Total</b>	<b>7</b>	<b>82</b>	<b>89</b>

Nga 89 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqesuara nga ana e prokurorit Moisi Duda gjatë vitit 2020, rezulton se qëndrimi i Gjykatës të Apelit në raport me ankimin e prokurorit në rreth, paraqitet si më poshtë:

- **Ankime të pranuar nga gjykata e Apelit janë: 7 çështje** në të cilat akuza është përkrahur në të dyja shkallët e gjykimit me objekt përkatësisht:
  - 5 themel/administrativo-penale
  - 2 masa sigurimi.
- **Ankime të rrëzuara nga gjykata e apelit janë: 82 ankime** të prokurorit të rrethit janë rrëzuar nga Gjykata e Apelit, të cilat të ndara sipas objektit të gjykimit rezultojnë:
  - 15 çështje me objekt themel me shkaqe ankimi, deklarim fajësie, mosaplikim të nenit 59 dhe caktim masë dënimi më të lartë:
  - 27 çështje me objekt administrativo-penale(mosfillim, dërgim çështje në gjyq, pushim çështje, zgjatje afati, rivendosje në afat, lirim me kusht):
  - 40 çështje me objekt masa sigurimi dhe shkak ankimi caktim mase arrest në burg

## ANALIZA E QËNDRIMIT TË MBAJTUR NGA PROKURORI DHE GJYKATA E APELIT NË LIDHJE ME ÇËSHTJET E ARDHURA ME ANKIM TË PANDEHURI

Për vitin 2020 janë gjykuar nga ky prokuror 261 çështje penale të ardhura mbi ankimin e të pandehurit. Të ndara sipas objektit të gjykimit ato ndahen në:

- 132 çështje me objekt themel dhe administrativo-penale
- 129 çështje me objekt masa sigurimi.

Qëndrimi i mbajtur nga prokurori i apelit dhe gjykata e apelit mbi 132 çështjet me objekt themel dhe administrativo-penale të ardhura mbi ankimin e të pandehurit dhe të dëmtuarve akuzues.

- **Ankime të papranuara:** 90 ankime të të pandehurit nuk janë përkrahur si nga prokurori i apelit ashtu edhe gjykata e apelit për të cilat gjykata e apelit ka ndarë të njëjtin qëndrim me prokurorin e apelit duke rrëzuar ankimet e të pandehurve dhe duke përkrahur akuzën në të dyja shkallët e gjykimit.
- **Gjykime të zhvilluara në dhomë këshillimi:** janë 18 çështje për të cilat gjykata e apelit ka vendosur:
  - në 9 raste mospranimin e ankimit të të pandehurit
  - në 6 raste ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit duke mospërkrahur ankimin e të pandehurit ose të dëmtuarit akuzues.
  - në 1 rast me objekt rivendosje në afat e gjykuar direkt në apel, gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit duke mos e pranuar kërkesën e të pandehurit për rivendosje në afat.
  - Në 1 rast me objekt kundërshtim vendim mosfillimi, gjykata e apelit ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim
  - Në 1 rast me objekt rivendosje në afat, e gjykuar direkt në apel, gjykata e apelit ka vendosur shpelljen e moskompetencës.
- **Ankime të pranuar nga Gjykata e apelit por të papërkrahura nga prokurorit i apelit** janë 24 raste ndër të cilat:
  - 1 rast me shkak ankimi deklarim pafajësie. Prokurori i apelit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të fajësisë, ndërsa gjykata e apelit ka pranuar ankimin e të pandehurit duke vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe deklarimin e pafajësisë. Prokurori i apelit ka ushtruar rekurs.
  - 2 raste me shkak ankimi lirim me kusht, prokurori i apelit ka kërkuar rrëzimin e kërkesës për lirim me kusht, ndërsa gjykata e apelit ka pranuar ka pranuar ankimin e të dënuarit duke vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe pranimin e kërkesës për lirim me kusht. Prokurori i apelit në të dyja rastet, ka ushtruar rekurs.
  - 21 raste janë kryesisht me shkak ankimi aplikim dënimesh alternative, masë dënime më të ulët etj, të cilat nuk janë përkrahur nga prokurori i apelit por janë pranuar nga gjykata e apelit. Në 5 raste (me shkak ankimi ndryshim cilësimi juridik të veprës penale, masë dënimi më të ulët dhe aplikim të nenit 59) është ushtruar rekurs nga prokurori i apelit.

Qëndrimi i mbajtur nga prokurorit i apelit dhe gjykata e apelit mbi 129 çështjet me objekt masa sigurimi të ardhura mbi ankimin e të pandehurit, paraqitet si vijon:

- **Ankime të papranuara janë 99 ankime** ku gjykata e apelit ka ndarë të njëjtin qëndrim me prokurorin e apelit duke rrëzuar ankimet e të pandehurve dhe duke përkrahur akuzën në të dyja shkallët e gjykimit.

- 8 çështje të zhvilluara në dhomë këshillimi, për të cilat gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit të të pandehurit.
- 22 ankime të pranuar nga Gjykata e apelit por të papërkrahura nga prokurorit i apelit.

### **Rekurse të ushtruara nga prokurori Moisi Duda:**

Nga 350 çështje të përfunduar për vitin 2020 (nga të cilat 132 janë me objekt themel dhe administrativo-penale dhe 129 çështje me objekt masa sigurimi), nga ky prokuror është ushtruar rekurs në 26 raste nga të cilat:

- 8 çështje të ardhura mbi ankim prokurori nga të cilat 6 me objekt themeli dhe 2 me objekt administrativo-penale.
- 9 çështje të ardhura mbi ankimin e të pandehurit nga të cilat 7 me objekt themel dhe 2 me objekt lirim me kusht.
- 9 çështje (nga të cilat 8 të ardhura me ankim prokurori dhe 1 e ardhur me ankim të pandehuri) me objekt masa sigurimi

### **Prokurori Afërdita NDOI**

Nga kjo prokurorë gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2020, është përfaqësuar akuza në gjykimin e 372 çështjeve penale, nga të cilat 41 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2019.

Nuk ka përfunduar gjykimin për 28 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2021, çështje kryesisht të regjistruara në muajin nëntor/dhjetor 2020.

Çështje të përfunduara në vitin 2020, janë 344, të cilat sipas objektit të gjykimit, rezultojnë: 175 çështje me objekt gjykimin e themelit dhe administrative penale dhe 169 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi.

Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 93 çështje (për 15 nga të cilat ka ushtruar ankim edhe i pandehuri), repektivisht për 53 çështje themeli e administrative penale dhe 40 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi.

### **Çështjet të përfunduara nga Prokurori Afërdita Ndoi vitit 2020**

<b>Viti 2020</b>	<b>Ankim Prokurori</b>	<b>Ankim Prok.+Pand.</b>	<b>Ankim të Pandehuri etj.</b>	<b>Totali</b>
Gjyk themeli dhe Administrative penale	45	8	122	175
Masa sigurimi	33	7	129	169
<b>Totali</b>	<b>78</b>	<b>15</b>	<b>251</b>	<b>344</b>

## **Qëndrimi i prokurorit të apelit në raport me ankimin e prokurorit të rrethit, paraqitet si më poshtë:**

Nga 93 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqesuara nga ana e prokurores Afërdita Ndoi gjatë vitit 2020, rezultojnë se qëndrimi i prokurorit të apelit në raport me ankimin e prokurorit të rrethit, paraqitet si më poshtë:

- **Ankime të përkrahura nga prokurorit i apelit janë 71 ankime** të cilat sipas objektit të gjykimit rezultojnë: 42 me objekt themel dhe administrativo penal dhe 29 janë me objekt masa sigurimi.
- Në 4 çështje gjithsej (2 me objekt themel dhe 2 masa sigurimi), prokurori i apelit nuk ka patur qëndrim ndaj ankimit të prokurorit të rrethit pasi janë zhvilluar në dhomë këshillimi.
- 18 ankime të prokurorit të rrethit (9 themeli+administrativo penale dhe 9 masa sigurimi) nuk janë përkrahur nga prokurori i apelit të cilat sipas objektit të gjykimit rezultojnë:
  - o për 4 çështje me objekt themel ku prokurori i rrethit ka kërkuar fajësi, fajësi pa dënime alternative(n.59+n.63), gjykata e rrethit ka vendosur në 2 çështje pafajësi(për të cilat si prokurori i apelit dhe gjykata e apelit kanë mbajtur qëndrim për mospranimin e ankimit). Në 1 çështje, ku gjykata e rrethit ka vendosur pushim çështje, prokurori i apelit dhe gjykata e apelit janë shprehur për lënien në fuqi të vendimit të pushimit të çështjes. Në çështjen tjetër ku gjykata e rrethit ka vendosur fajësi + aplikim të nenit 59 të k.penal prokurori i apelit dhe gjykata e apelit janë shprehur për lënien në fuqi të vendimit të rrethit.
  - o për 5 çështje administrativo-penale (2 me objekt pushim çështje, 2 me objekt kundërshtim vendim mosfillimi dhe 1 me objekt dërgim çështje në gjyq) prokurori i apelit ka kërkuar:
    - për 2 çështjet me objekt mosfillimi në njërin rast lënien në fuqi të vendimit të gjykatës për vazhdim hetimesh dhe në rastin tjetër ku gjykata e rrethit ka vendosur vazhdimin e hetimeve, prokurori ka kërkuar kthimin e çështjes për rigjykim. Në të 2 çështjet gjykata e apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim me prokurorin e apelit.
    - Në 2 çështje me objekt pushim çështje, ku gjykata e rrethit ka vendosur vazhdim hetimesh, në të dy rastet prokurori në apel ka hequr dorë nga ankimi dhe gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit.
    - Në 1 çështje me objekt dërgim në gjyq, ku gjykata e rrethit ka vendosur pushimin e çështjes, si prokurori në apel ashtu edhe gjykata e apelit kanë mbajtur të njëjtin qëndrim për mospranimin e ankimit të prokurorit në rreth.
  - o Për 9 çështje me objekt masë sigurimi, dhe shkak ankimi caktimin e masës arrest në burg, prokurori i apelit ka kërkuar:
    - 5 raste ku gjykata e rrethit ka vendosur masën e sigurimit arrest në shtëpi paraqiten në këtë mënyrë: për 2 raste si prokurori i apelit ashtu edhe gjykata e apelit kanë ndarë të njëjtin qëndrim për miratimin e vendimit të gjykatës së rrethit për masën arrest në shtëpi. 2 raste si prokurori i apelit ashtu edhe gjykata e apelit janë shprehur për mospranimin e ankimit të prokurorit. Në 1 rast prokurori i apelit ka hequr dorë nga ankimi dhe gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit.
    - 4 raste ku gjykata e rrethit ka vendosur masën e sigurimit detyrim paraqitje paraqiten në këtë mënyrë: në 2 raste si prokurori i apelit ashtu edhe gjykata e apelit janë shprehur për miratimin e vendimit, dhe në 2 rastet e tjera prokurori i apelit ka hequr dorë nga ankimi dhe gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit.

Ngarkesa e prokurorit Afërdita Ndoi, sipas qëndrimit të saj në raport me ankimin e prokurorit dhe objektit të gjykimit çështjes, paraqitet me treguesit si më poshtë:

Objekti gjykimit	Përkrahur	Pa qëndrim (dhomë këshillim/mungesë)	Jo përkrahur	Hequr dorë nga ankimi	Total
Themel	16	2	4		22
Masa sigurimi	29	2	6	3	40
Kund.vend mosfillimi	3		2		5
Pushim çështje	14			2	16
Dergim çështje në gjyq	4		1		5
Njohje ditë burgu	1				1
Qëndrim në shtëpi	1				1
Shuarje dënimi	1				1
Lirim me kusht	2				2
<b>Total</b>	<b>71</b>	<b>4</b>	<b>13</b>	<b>5</b>	<b>93</b>

#### Qëndrimi i Gjykatës së Apelit në raport me ankimin e prokurorit të rrethit

Qëndrimi i Gjykatës së Apelit në raport me ankimin e prokurorit të rrethit dhe sipas objekteve të gjykimit çështjes, paraqitet me treguesit si më poshtë:

Objekti gjykimit	Qëndrimi i Gjykatës e Apelit		Total
	Pranuar	Rrëzuar	
Themel	1	19	20
Kund.vend mosfillimi	2	4	6
Pushim çështje	6	10	16
Dergim çështje në gjyq	1	5	6
Aplikim dënimi alternativ qëndrim në shtëpi	0	1	1
Shuarje ekzekutimi vendimi penal	0	1	1
Njohje dite burgu	0	1	1
Lirim me kusht	2	0	2
Masa sigurimi	6	34	40
<b>Total</b>	<b>18</b>	<b>75</b>	<b>93</b>



Nga 93 ankime të prokurorëve të shkallës parë të përfaqesuara nga ana e prokurorit Afërdita Ndoi gjatë vitit 2020, rezulton se qëndrimi i Gjykatës të Apelit në raport me ankimin e prokurorit në rreth, paraqitet si më poshtë:

- **Ankime të pranuar nga Gjykata e Apelit janë: 18 çështje** nga të cilat 12 janë me objekt themel dhe administrativo-penale dhe 6 janë me objekt masa sigurimi.
- **Ankime të rrëzuara nga Gjykata e Apelit janë 75 çështje**, të cilat të ndara sipas objektit të gjykimit rezultojnë:
  - 19 çështje me objekt themel nga të cilat:
    - në 15 çështje prokurori i apelit ka përkrahur qëndrimin e prokurorit të rrethit por gjykata nuk ka përkrahur akuzën në të dyja shkallët e gjykimit.
    - në 4 çështje, prokurori i apelit dhe gjykata e apelit kanë ndarë të njëjtin vlerësim për mospranimin e ankimit të prokurorit në rreth.
  - 22 çështje me objekt administrativo-penale(5 çështje dërgim për gjyq; 4 çështje kundërshtim vendim mosfillimi; 10 çështje kundërshtim vendim pushimi; 1 çështje aplikim dënimi alternativ “qëndrim në shtëpi”; 1 çështje shuarje ekzekutimi vendimi penal, 1 çështje njohje ditë burgu). Nga këto:
    - në 4 raste, Prokurori i Apelit dhe gjykata e apelit kanë mbajtur të njëjtin qëndrim duke mos përkrahur qëndrimin e prokurorit në rreth(1 rast nga këto prokurori i apelit ka hequr dorë nga ankimi).
    - Në 3 raste janë zhvilluar në dhomë këshillimi dhe gjykata apelit për të 3 rastet nuk e ka përkrahur ankimin e prokurorit në rreth .
    - Në 15 raste me objekte (pushim, mosfillim, dërgim gjyq, qëndrim në shtëpi, shuarje ekzekutimi vendimi penal), prokurori i apelit ka përkrahur ankimin e prokurorit në rreth, ndërsa gjykata e apelit nuk e ka përkrahur akuzën në asnjë nga shkallët e gjykimit.
  - 34 çështje me objekt masa sigurimi, nga të cilat:
    - në 25 raste, prokurori i apelit ka përkrahur qëndrimin e prokurorit të rrethit por gjykata nuk ka përkrahur akuzën në të dyja shkallët e gjykimit.
    - Në 6 raste prokurori i apelit dhe gjykata e apelit kanë mbajtur të njëjtin qëndrim mbi ankimin e prokurorit duke mos e pranuar atë.
    - në 3 çështje, prokurori i apelit ka hequr dorë nga ankimi i prokurorit të rrethit dhe gjykata për këto 3 raste ka vendosur mospranimin e ankimit.

## **ANALIZA E QËNDRIMIT TË MBAJTUR NGA PROKURORI DHE GJYKATA E APELIT NË LIDHJE ME ÇËSHTJET E ARDHURA ME ANKIM TË PANDEHURI**

Për vitin 2020 janë gjykuar nga ky prokuror 251 çështje penale të ardhura mbi ankimin e të pandehurit. Të ndara sipas objektit të gjykimit ato ndahen në:

- 122 çështje me objekt themel dhe administrativo-penale
- 129 çështje me objekt masa sigurimi.

Qëndrimi i mbajtur nga prokurorit i apelit dhe gjykata e apelit mbi 122 çështjet me objekt themel dhe administrativo-penale të ardhura mbi ankimin e të pandehurit dhe të dëmtuarve akuzues.

- **Ankime të të pandehurit të papërkrahura si nga gjykata e apelit ashtu edhe nga prokurori i apelit janë 71 ankime** në të cilat gjykata e apelit dhe prokuroria e apelit kanë mbajtur të njëjtin qëndrim për rrëzimin e ankimeve të të pandehurve, duke përkrahur akuzën në të dyja shkallët e gjykimit.
- **Gjykime të zhvilluara në dhomë këshillimi:** janë 24 çështje për të cilat gjykata e apelit ka vendosur:
  - në 8 çështje me objekt administrativo-penal(pushim çështje, dërgim gjyq, rishikim vendimi), gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve të gjykatave të rrethit duke mospranuar ankimet e të pandehurve.
  - në 14 çështje me objekt kryesisht themeli, gjykata e apelit ka mospranimin e ankimit të të pandehurve.
  - në 1 rast me objekt rishikim vendimi, gjykata e apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.
  - në 1 rast me objekt ndreqje gabimi, gjykata e apelit ka vendosur pranimin e kërkesës për ndreqje gabimi.
- **Ankime të pranuar nga Gjykata e apelit por të papërkrahura nga prokurorit i apelit por janë 27 raste** ndër të cilat:
  - 15 janë me objekt themel.
  - 12 raste me objekte të ndryshme administrativo-penale.

Qëndrimi i mbajtur nga prokurorit i apelit dhe gjykata e apelit mbi 129 çështjet me objekt masa sigurimi të ardhura mbi ankimin e të pandehurit, paraqitet si vijon:

- **Ankime të të pandehurit të papërkrahura si nga gjykata e apelit ashtu edhe nga prokurori i apelit janë 90 raste** për të cilat gjykata e apelit ka ndarë të njëjtin qëndrim me prokurorin e apelit duke rrëzuar ankimet e të pandehurve dhe duke përkrahur akuzën në të dyja shkallët e gjykimit.
- **Gjykime të zhvilluara në dhomë këshillimi:** janë 7 çështje për të cilat gjykata e apelit ka vendosur mospranimin e ankimit të të pandehurit.
- **Ankime të pranuar nga Gjykata e apelit por të papërkrahura nga prokurorit i apelit janë 32 çështje.**

#### **Rekurse të ushtruara nga prokurori Afërdita Ndoi**

Nga 344 çështje të përfunduara për vitin 2020(nga të cilat 175 janë me objekt themel dhe administrativo-penale dhe 169 çështje me objekt masa sigurimi), nga ky prokuror është ushtruar rekurs në 20 raste nga të cilat:

→ 14 rekurse janë ushtruar për çështje me objekt themel dhe administrativo-penale:

- 7 çështje të ardhura mbi ankim prokurori nga të cilat:
  - 4 çështje janë me objekt themeli
  - 2 me objekt dërgim çështje në gjyq
  - 1 me objekt shuarje dënimi
- 7 çështje të ardhura mbi ankim të pandehuri nga të cilat:
  - 4 çështje janë me objekt themeli
  - 1 me objekt njohjen vendimi penal të huaj,
  - 1 me objekt lirim me kusht.
  - 1 me objekt përlllogaritje dënimi

- 6 rekurse janë ushtruar për çështje me objekt masa sigurimi nga të cilat
- 2 çështje të ardhura me ankim prokuori
  - 4 çështje të ardhura me ankim të pandehuri.

### **Organizimi, përfaqësimi i akuzës dhe ushtrimin e ndjekjes penale në Prokurorinë e Apelit Durrës.**

Çështjet e planifikuara për gjykim nga ana e gjykatës apelit Durrës merren nga kryesekretaria e kësaj prokurorie dhe regjistrohet në regjistrin elektronik duke pasqyruar të gjithë treguesit e nevojshëm. Grupimi i dosjeve penale bëhet menjëherë nga drejtuesi i kësaj prokurorie i cili në prani të gjithë prokurorëve dhe sekretarisë organizon dhe realizon hedhjen e shortit. Pas hedhjes së shortit prokurorët marrin menjëherë dosjet e caktuara me short dhe nga administrata e prokurorisë bëhet fotokopjimi i akteve të nevojshme dhe ja dorëzon ato secilit prokuror.

Nga ana e prokurorëve të Prokurorisë Apelit Durrës, dhe jo vetëm pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese e ligjore si rezultat i reformës në drejtësi, vlerësimi dhe vendimarrja e prokurorëve në çdo rast ka qenë e bazuar në vlerësimin dhe bindjen e tyre të brendshme dhe me pavarësi të plotë.

Objekt i punës së Prokurorëve të kësaj prokurorie është edhe verifikimi dhe vlerësimi i problematikave në ushtrimin e ndjekjes penale nga ana e Prokurorive të Rretheve Gjyqësore Durrës, Elbasan dhe Kavajë, gjatë hetimit dhe gjyqimit të këtyre çështjeve penale. Në këtë drejtim nga të gjithë prokurorët e kësaj prokurorie duhet bërë më shumë dhe sidomos në evidentimin e tyre në akte përkatëse.

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**LUDOVIK DODAJ**



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text: 'REPUBLIKA E SHQIPERISE', 'PROKURORIA PRANE GJYKATES SE', 'APELIT DURRES'. The signature is written in a cursive style.